



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS  
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018**

**Prishtinë, qershor 2019**

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërdrejt llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të *Ministritë së Infrastrukturës*, në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm *Qerkin Morina*, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga *Udhëheqësi i ekipit Sabile Musa dhe anëtare e ekipit Laureta Matoshi - Pozhegu*, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit *Blerim Kabashi*.

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit .....	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm .....	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli .....	10
4 Qeverisja e mirë.....	27
5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	30
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA .....	38
Shtojca II: Letër Konfirmimi. ....	41

## Përmbledhje e përgjithshme

Ky raport përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Ministrisë së Infrastrukturës për vitin 2018, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2018 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 26.10.2018.

Auditimi është fokusuar në:



Niveli i angazhimit për të kryer auditimin është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Ministrisë së Infrastrukturës.

### Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

#### Opinion i Pamodifikuar me theksim të çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2018 paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, përveç çështjeve në vijim:


#### Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për për parregullsitë si vijon:

- (a) Nga kategoria e investimeve kapitale ishin buxhetuar dhe paguar për kontratat e mirëmbajtjes së rrugëve vlera prej 689,310€, të cilat për nga natyra i takojnë kategorisë së shërbimeve. Si rezultat i kësaj, edhe pasuritë janë mbivlerësuar për të njëjtën vlerë;
- (b) Shpenzimet për projektin “Dislokim të varrezave nga Traseja e Autoudhës R6, Prishtinë-Hani i Elezit” në vlerë prej 353,589€ janë paguar nga MI, si pasojë e tejkalimit të sasive të parashikuara me kontratën bazë;
- (c) Shuma prej 153,554€ ishte paguar për kompenzimin e pagave për 32 zyrtarë, për të cilët nuk ka dëshmi të paraqitjes së tyre në vendin e punës; si dhe
- (d) Si pasojë e mungesës së kontrolleve, një faturë në shumën prej 47,168€ ishte paguar dy herë.

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

**Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore****Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2018**

Ministri është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

---

# 1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase.
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Ministrisë së Infrastrukturës, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Gjetjet e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përmbledhje të detajuar të gjetjeve tona të auditimit dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Përgjigjet e menaxhmentit në rezultatet e auditimit mund të gjenden në Shtojcën II.

## 2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm

Auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese dhe cilësinë e saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV, përfshirë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar dhe se një proces auditimi mund të ndërmerret.

### 2.1 Opinioni i auditimit

#### Opinion i Pamodifikuar me Theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Ministrisë së Infrastrukturës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore.

#### Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

#### Theksimi çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se:

Shpenzimet për mirëmbajtjen e rrugëve në vlerë prej 689,310€ janë paguar nga buxheti i investimeve kapitale. Kontratat e mirëmbajtjes në bazë të të cilave janë kryer aktivitetet, si: largimi i vegjetacionit, heqja e borës, hedhja e kripës, prerja e barit, monitorimi, inspektimi etj. nuk përmbajnë elemente të shpenzimeve kapitale. Arsyeja për këtë keq klasifikim është planifikimi nga MI dhe aprovimi i buxhetit nga Kuvendi i Kosovës, duke ndikuar në mbivlerësim të Investimeve Kapitale dhe

nënvlerësim të Mallrave dhe Shërbimeve. Për të njëjtën vlerë, edhe pasuritë kapitale janë mbivlerësuar.

Shpenzimet për projektin "Dislokim të varrezave Traseja e Autostradës R6" në vlerë prej 832,236€ janë paguar nga MI për periudhën trevjeqare 2016-2018. Vlera e kontratës bazë, përfshirë edhe aneks kontratën e vitit 2016 ishte 66,000€, numri i varrezave 40, çmimi për njësi i kontraktuar 1,711€. Si pasojë e tejkalimit të sasive të parashikuara me kontratën bazë, MI kishte bërë pagesa për zhvarrosjen dhe rivarrosjen edhe të 434 personave tjerë në vlerë prej 766,235€. Sasitë e tejkaluara ishin paguar duke iu referuar kontratës së vitit 2016. Prej shumës totale të paguar, 353,589€ janë pagesa të kryera për vitin 2018.

Në MI, pas një procesi të rekrutimit me akt emërimi ishin integruar 32 nëpunës të komunitetit serb, ish pjesëtarë të "Mbrojtjes Civile". Këta punonjës ishin planifikuar të sistemohen nëpër komunitat në pjesën veriore të Kosovës, në pozita të caktuara brenda departamenteve përkatëse në ministri.

Për zyrtarët e lartcekur, ministria nuk posedon dëshmi që konfirmojnë paraqitjen e tyre në vendin e punës, siç i obligon rregullorja nr. 05/2010 e orarit të punës, përderisa ministria kishte bërë pagesën e rregullt të pagave të tyre. Vlera financiare për shpenzimet e pagave për vitin 2018, për 32 zyrtarë ishte 153,554€. Kjo ka ndodhur për shkak se nuk janë zbatuar kontrole menaxheriale për të siguruar se të gjithë të punësuarit janë të pranishëm në vendin e punës gjatë orarit të punës.

Gjithashtu, me datën 29.11.2018 ishte ekzekutuar një pagesë me vendim gjyqësor në vlerë 47,168€ nga ana e përmbauesit privat për projektin "Asfaltimi i rrugës Jashanicë - Klinë". E njëjta faturë në po të njëjtën vlerë, me datën 26.12.2018 është paguar edhe nga MI. Ministria ka filluar procedurën për kthimin e pagesës, por deri në përfundim të auditimit, kthimi mjeteve nga kompania nuk është kryer.

Për çështjet e përmendura më lart, ne nuk e kemi modifikuar opinionin për shkak se nuk kalohet pragu i materialitetit.

### **Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV**

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Infrastrukturës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, dhe për kontrollet e brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116, Ligjin nr.04/L-194, Ligjin nr. 05/L-063 dhe Ligjin nr. 05/L-007.

Ministri është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Infrastrukturës.



---

## Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave të SNISA-ve, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbuloj çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

## 2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Ministria e Infrastrukturës kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFPP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullat Financiare Nr. 01/2013 për Shpenzimin e Parave Publike dhe Rregullën MF Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Planin përfundimtar të Prokurimit;
- Raportet tremujore; dhe
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK).

Lidhur me PFV-ve, kemi identifikuar çështjen si vijon:

---

- Te neni 17 - Në raportin për detyrimet e papaguara në PFV, prej 38,495,831 nuk ishin përfshirë detyrimet për Subvencioneve dhe Transfereve prej 94,718€, dhe për të njëjtën shumë, totali i këtyre detyrimeve ishte nënvlerësuar.

Në PFV ishin të nevojshme disa korrigjime financiare, për të cilat kemi dhënë sugjerime për të përmirësuar cilësinë e tyre, si në vijim:

- Te neni 14 - Raporti i ekzekutimit të buxhetit - tek pjesa e pagesave buxheti final ishte nënvlerësuar për vlerën prej 244,639€ krahasuar me ndarjen përfundimtare në SIMFK. Kjo ka ndodhur pasi MI për kategorinë e Mallrave dhe Shërbimeve ka marrë për bazë raportin e alokimeve për përgatitjen e PFV-ve për 2018.

#### DEKLARATA E BËRË NGA MENAXHMENTI MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet e pasaktë për shkak se gjatë auditimit janë identifikuar gabime materiale.

Lidhur me kërkesat tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

## 2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

**Rekomandimi B1** Ministri duhet të siguroj se është bërë një analizë për të përcaktuar shkaqet për të Theksim të Çështjes së opinion dhe eliminimin e tyre. Prandaj, veprime specifike duhet të ndërmerren për t'i adresuar shkaqet për të eliminuar keq klasifikimet dhe pagesat e parregullta, që duhet të jenë në përputhje me kërkesat e ligjeve në fuqi.

**Rekomandimi A1** Po ashtu, duhet të siguroj se me rastin e përgatitjes së PFV të vendos proceset efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV-ve për vitin 2019 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Të siguroj se do të ndërmerren hapa për të siguruar të prezantim të saktë të obligimeve të papaguara, siç kërkohet me rregullat e Thesarit.

## 3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore dhe pasuritë e detyrimet.

---

## Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrolleve, prokurimi mbetet shqetësimi i madh, për shkak të zbatimit të dobët të rregulloreve, duke rezultuar në vlerë të dobët për para, si dhe vonesa në përfundimin e projekteve.

Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat në përgjithësi janë të mira dhe janë duke u zbatuar në mënyrë efektive, por kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm për të parandaluar parregullsinë e shpenzimeve, duke anashkaluar kushtet dhe rregullat buxhetore që duhet të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe ligjeve në fuqi.

Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë realizimi i buxhetit dhe menaxhimi i kontratave të prokurimit, realizimi i marrëveshjeve me bashkëfinancim, menaxhimi i kontratave për mirëmbajtje, kontrollet e personelit për vajtje-ardhje në punë, menaxhimi i marrëveshjeve për shërbime të veçanta, menaxhimi i pasurive etj.

Buxheti i realizuar kundrejt ndarjeve fillestare, ishte në shpërputhje të madhe. MI, për shkak të vonesave në themelimin e njësive për implementimin e projekteve, nuk kishte qenë në gjendje t'i shfrytëzoj fondet nga klauzola e investimeve prej 57 milionësh.

Projektet shumëvjeçare shoqërohen me barriera të shumta, duke filluar nga krijimi i parakushteve për fillimin e punimeve e deri te pranimiti teknik apo dhënia e tyre në përdorim. Si arsye e kësaj, nga fillimi deri në realizimin përfundimtar të projekteve, janë vërejtur vonesa të theksuara.

Ministria, gjithashtu, ka disa memorandume bashkëfinancimi me komuna. Këto projekte, në masë të madhe financohen nga ministria, por nuk monitorohen mjaftueshëm nga ana e ministrisë. Në raste të caktuara, memorandumet për bashkëfinancim bëhen para se të jenë krijuar parakushtet për fillimin e projektit, siç janë: ekzaminimet në terren, projektet ekzekutive, zgjidhja e çështjeve pronësore, marrja e lejeve/pëlqimeve për kyçje në kanalizim, ujësjellës, rrjet elektrik, etj.

Në aspektin e klasifikimit të buxhetit dhe shpenzimeve, ka probleme me trajtimin kontabël të shpenzimeve, dhe si rezultat i kësaj, shpenzimet e mirëmbajtjes që duhet trajtuar si shpenzime për shërbime, janë trajtuar si investime kapitale.

Kontrollet në fushën e pagesave janë efektive. Si pasojë e disiplinës së dobët financiare, mbi 4.5 milionë të pagesave janë ekzekutuar nga ana e Thesarit dhe me vendime gjyqësore.

Të gjitha çështjet e përmendura më lart, më gjerësisht janë trajtuar në brendi të raportit.

### 3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final <sup>1</sup>	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
<b>Burimet e Fondeve:</b>	<b>304,572,759</b>	<b>310,932,813</b>	<b>244,826,294</b>	<b>234,379,056</b>	<b>213,025,341</b>
Granti i Qeverisë - Buxheti	164,922,759	166,841,207	166,079,589	234,309,830	213,025,341
Financimi nga Huamarrja	12,350,000	12,350,000	4,293,372	69,226	0
Klauzola e Investimeve	57,000,000	57,000,000	0	0	0
Te hyrat njëhershme nga AKP	70,300,000	74,741,606	74,453,333	0	0

Siç shihet nga tabela, buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 6,360,054€. Kjo rritje është rezultat rritjes së buxhetit nga të hyrat e njëhershme nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) dhe rritjes së aplikueshme në pajtim me vendimet e Qeverisë. Mirëpo buxheti në fund të vitit kishte rezultuar me tepricë buxhetore prej 66,106,520€.

Sipas Ligjit Buxhetit Nr. 06/L020, buxheti për projektet kapitale përmes klauzolës së investimeve ishte 57,000,000€, i destinuar për financimin e tri projekteve:

(a) Zgjerimi dhe rehabilitimi i Rrugës magjistrale M9 Prishtinë-Pejë 37,000,000€, (b) Rehabilitimi i Rrugëve Rajonale 10,000,000€ dhe (c) Rehabilitimi i linjës hekurudhore Fushë Kosovë - Hani i Elezit në vlerë 10,000,000€. Dështimi i realizimit të këtyre projekteve është rezultat i mos arritjes së krijimit të njësive zbatuese për menaxhimin e projekteve.

Po ashtu, nuk ishin shpenzuar edhe fondet tjera në dispozicion, si: huamarrja nga fondi arab për financimin e rrugëve regjionale në vlerë 8,056,628€ për shkak të pengesave në rrugë të paraqitura me rastin realizimit të punimeve, buxheti prej 108,231€ për projekte të infrastrukturës lokale, dhe buxheti për kategoritë mallra, shërbime, komunalit dhe subvencione e transfere në vlerë 941,661€.

Në vitin 2018, MI ka shpenzuar 244,826,293€ apo 79% të buxhetit final, me një përkeqësim në performancë prej 19% krahasuar me vitin 2017. Realizimi i buxhetit mbetet në nivel jo të kënaqshëm, dhe më poshtë, jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

<sup>1</sup> Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:</b>	<b>304,572,759</b>	<b>310,932,813</b>	<b>244,826,294</b>	<b>234,379,056</b>	<b>213,025,341</b>
Pagat dhe Mëditjet	1,874,604	1,829,911	1,829,911	1,743,492	1,716,303
Mallrat dhe Shërbimet	6,603,323	7,023,323	6,594,681	5,776,727	5,883,302
Shërbimet komunale	375,190	326,190	154,243	137,337	153,637
Subvencionet dhe Transferet	1,443,814	1,382,814	1,041,743	1,442,658	832,678
Investimet Kapitale	294,275,828	300,370,575	235,205,716	225,278,842	204,439,421

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore përfshirë arsyet dhe ndikimin që kanë pasur:

- Buxheti për paga dhe mëditje, ishte reduktuar me Vendim të Qeverisë për 44,693€ si rezultat i kursimeve buxhetore;
- Rritja e buxhetit për mallra dhe shërbime për 420,000€ është rezultat i vendimeve të Qeverisë nga kursimet për pagesën e mirëmbajtjeve të rrugëve dhe rekrutimit të një numri të ri të stafit me marrëveshje për shërbime të veçanta;
- Buxheti për subvencione dhe transfere, ishte reduktuar me vendime të Qeverisë për 61,000€, si rezultat i kursimeve buxhetore;
- Buxheti për investime kapitale ishte rritur për 6,094,747€. Kjo rritje vjen nga të hyrat e njëhershme të AKP-së për 4,441,606€ dhe nga vendimet e Qeverisë 1,653,141€. Programi për Investime Publike përfshin 261 projekte kapitale për vitin 2018, prej të cilave 188 kishin progres financiar mbi 90% të vlerës së buxhetuar, 12 projekte ishin me një përqindje të ultë të realizimit, dhe pjesa tjetër ishin projekte të reja; dhe
- Sipas Ligjit buxheti Nr. 06/L-020 për vitin 2018 në tabelën 3.2 ishin të përfshira gjithsej 61 projekte, të cilat nuk kanë filluar të realizohen gjatë vitit 2018. Buxheti për këto projekte ishte transferuar në projekte tjera që ishin në proces të realizimit gjatë vitit 2018. Arsyet për mos fillimin e realizimit të këtyre projekteve në vitin 2018 ishin projektet e planifikuara përmes bashkëfinancimeve me komunat e Kosovës, ku procedurat e projektimit dhe planifikimit i janë deleguar Komunave përkatëse. Për shkak të vështirësive të ndryshme që kishin komunat, projektet janë shtyrë për vitin 2019.

## Çështja A2<sup>2</sup> - Performancë e dobët në ekzekutimin e buxhetit

**Gjetja** Buxheti final ishte realizuar vetëm 79%. MI nuk kishte arritur performancë të mirë buxhetore, sidomos në kategorinë e investimeve kapitale, ku realizimi i buxhetit final ishte 235,205,716€ apo 78%. Kjo përqindje e ultë e realizimit vjen për shkak të mos realizimit të projekteve të planifikuara me klauzolën e investimeve dhe projekteve të planifikuara për financim nga huamarrja prej fondit arab.

Kjo kishte ndodhur për shkak se njësitë implementuese për zbatimin e projekteve respektive ishin krijuar me vonesë.

**Rreziku** Ekzekutimi i dobët i buxhetit dhe mos realizimi i projekteve, rezulton me shfrytëzim jo efikas të fondeve publike dhe mos arritjen e objektivave të ministrisë.

**Rekomandimi A2** Ministri duhet të ndërmerrë veprime për funksionalizimin me kohë të njësive zbatuese të projekteve, në mënyrë që projektet kapitale të realizohen konform marrveshjeve të arritura.

### 3.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga MI në 2018 ishin 2,805,710€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga lëshimi i patentë shoferëve, të hyrat nga ripërtëritja e licencave, aplikimi për licenca vendore dhe transport etj.

**Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Pranimet	2017 Pranimet	2016 Pranimet
Të hyrat vetjake	1,865,000	1,865,000	2,805,710	2,501,388	2,510,869
<b>Totali</b>	<b>1,865,000</b>	<b>1,865,000</b>	<b>2,805,710</b>	<b>2,501,388</b>	<b>2,510,869</b>

Të hyrat e realizuara nga MI depozitohen në Fondin e Kosovës dhe regjistrohen në SIMFK në pajtim me Rregullat Financiare të Thesarit, dhe nuk janë të autorizuara për shpenzim të MI-së.

Për vitin 2018 janë realizuar 150% e të hyrave të planifikuara. Prej tyre, 58% janë të realizuara nga lëshimi i patentë shoferëve, dhe krahasuar me vitin paraprak ka një rritje prej 304,322€ apo 12%. Ne

<sup>2</sup> Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja  
 Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura  
 Çështja C dhe Rekomandimi C - nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.

kemi aplikuar testimet substanciale dhe të pajtueshmërisë, por nga testimet e bëra nuk kemi identifikuar ndonjë parregullsi.

## Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë

### 3.1.2 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe shtesat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga Ministria e Administratës Publike (MAP) dhe Ministria Financave (MF). Megjithatë, janë një sërë kontrollesh të cilat operojnë në kuadër të MI-së, të cilat ndërlidhen me përcaktimin e koeficienteve për paga, avancime dhe aprovimin e shtesave etj. Prandaj është e rëndësishme që të ketë kontrolle efektive për të siguruar se këto veprime janë në përputhje me rregullat e përgjithshme.

Sipas shënimeve të SIMFK-së, buxheti për kategorinë e pagave dhe mëditjeve për vitin 2018 ishte 1,874,604€, ndërsa realizimi i shpenzimeve për vitin 2018 ishte 1,829,911€ apo 98%.

---

## Çështja A3 – Të punësuarit me Marrëveshje për Shërbime të Veçanta (MSHV) pa procedurë të thjeshtësuara të rekrutimit

**Gjetja** Sipas Ligjit për Shërbyes civil nr.03/L-149, neni 12, organizatat buxhetore mund të angazhojnë punëtorë me afat të caktuar në bazë të kontratave “Marrëveshje për shërbime të veçanta” (MSHV), për më pak se gjashtë muaj. Angazhimi i tyre do të bëhet në bazë të kontratave të quajtura (MSHV) të cilat i nënshtrohen Ligjit për marrëdhënie detyimore dhe për të cilat zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit.

Ne fund të vitit, përmes MSHV-ve ishin të angazhuar 135 nëpunës për pozita të ndryshme. Prej tyre, 68 janë të punësuar pa procedurë të thjeshtësuar të rekrutimit. Disa nga pozitat e mbuluara me nëpunës me MShV, janë pozita të rregullta, si: Zyrtar Financiar, Zyrtar për Buxhet dhe Financa, Zyrtar Personeli, Zyrtar i IT-së. Po ashtu, MI për të njëjtit zyrtar aplikon vazhdimin e kontratave të tilla çdo gjashtë (6) muaj.

Përveç numrit të mësipërm, 29 të punësuar tjerë me MSHV ishin të angazhuar në pozita të ekzaminerëve. Kontratat paraprake iu kishin skaduar më 31.10.2017, por të njëjtit kishin vazhduar të punojnë edhe gjatë vitit 2018 pa kontrata. Pagat e tyre për kohën sa kanë punuar pa kontrata, janë paguar në tremujorin e parë të vitit 2019, pas nënshkrimit të Marrëveshjes për Shërbime të Veçanta në vitin 2019.

**Rreziku** Angazhimi i nëpunësve me MSHV për pozita të rregullta, pa procedurë dhe në mungesë të transparencës, rritë rrezikun për plotësimin e pozitave me staf jo kompetent, pa përgatitjen e duhur profesionale dhe eksperiencën e mjaftueshme për të kryer detyra zyrtare.

**Rekomandimi A3** Ministri duhet të siguroj që angazhimi i stafit me MSHV bëhet në pajtim të plotë me kërkesat e rregulloreve, respektivisht procedurat zbatohen me transparencë e plotë, duke marrë parasysh përgatitjen profesionale dhe performancën e kandidatëve të rekrutuar. Veç kësaj, në koordinim me MF dhe MAP të rishikojnë mundësinë që pozitat e rregullta të plotësohen sipas Ligjit për shërbimin civil.

### 3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime, përfshirë shërbimet komunale në vitin 2018 ishte 7,349,513€. Prej tyre ishin shpenzuar 6,748,924€. Ato kanë të bëjnë me shpenzimet e mirëmbajtjes së rrugëve për vitet 2017-2018, pagesat sipas neni 39.2 të LMFP, pagesat me vendim të gjykatës, shërbime tjera kontraktuese, karburante për vetura, qira për zyre.

Ne kemi aplikuar testime substanciale dhe të pajtueshmërisë, dhe nga këto testime kemi identifikuar parregullsitë si në vijim:

#### Çështja A4 - Pagesat e kryera nga Thesari dhe me Vendime të Gjykatave

**Gjetja** Në bazë të autorizimeve që dalin nga Ligji i Menaxhimit Financave Publike dhe Përgjegjësit (LMFP) neni 39.2, Thesari gjatë vitit ka trajtuar kërkesat e operatorëve ekonomik për pagesën e faturave të vonuara mbi 60 ditë nga MI.

Në vitin 2018 Thesari ka shqyrtuar kërkesat e operatorëve ekonomik për pagesën e faturave të vonuara dhe të papaguara nga MI, dhe ka aprovuar gjithsej 22 fatura për pagesë në vlerë prej 4,184,557€ (për shtatë operatorë ekonomik) bazuar në vendimet e gjykatave, ndërsa përmbaruesit privat kanë ekzekutuar edhe 502,311€ në llogari të operatorëve ekonomik.

Pagesat kanë të bëjnë kryesisht me mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve. Nga lëndët e testuara për regjionin Prishtina lot 1, vlera e pagesave ishte 848,838€, dhe regjioni Gjilani lot 1, vlera e pagesave ishte 1,824,212€. Ekzekutimi i pagesave nga Thesari ishte bërë për shkakun se këto obligime nuk ishin paguar për vite me radhë, si pasojë e mos koordinimit ndërmjet njërive kërkuese, menaxherëve të kontratave dhe zyrës së prokurimit.



**Rreziku** Mos kryerja e obligimeve me kohë nga MI, ka shkaktuar ekzekutim të detyrueshëm të pagesave nga ana e Thesarit dhe përmes procedurave gjyqësore. Kjo mënyrë e realizimit të pagesave mund të rritë rrezikun e mosrealizimit të projekteve të reja për shkak të pagesave për projektet e mëhershme.

**Rekomandimi A4** Ministri duhet të siguroj se janë vendos kontrolle efektive financiare dhe të arrihet një koordinim më i mirë ndërmjet njësisë kërkuese, menaxherit të kontratave, dhe zyrës së prokurimit, në mënyrë që të gjitha obligimet të paguhen me kohë dhe të shmanget mundësia e pagesave shtesë për procedura gjyqësore, kamatë vonesa dhe shpenzime të përmbarimit.

### 3.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 1,382,814€, dhe prej tyre ishin shpenzuar 1,041,743€. Ato kanë të bëjnë me subvencionimin në bazë të marrëveshjes për kompensimin e obligimit të shërbimeve publike për periudhën 2018-2022 me kompaninë publike të operimit Trainkos sh.a. Marrëveshja është nënshkruar me datën 18.04.2018 për linjat Fushë Kosovë – Hani i Elezit – Fushë Kosovë (dy trena) dhe Prishtinë – Pejë – Prishtinë (katër trena).

Ne kemi aplikuar testime substanciale dhe të pajtueshmërisë, dhe nga testimet e bëra nuk kemi identifikuar ndonjë parregullsi.

#### Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë

### 3.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 300,370,575€, prej tyre në 2018 ishin shpenzuar 235,205,716€ apo 78%. Ato kanë të bëjnë me realizimin e projekteve, si: ndërtimin e Autoudhës Prishtinë - Hani i Elezit, ndërtimin e Autoudhës Gjilan – Konçul, dhe Zgjerimi i pistës së aeroportit, ngritja e sistemit të aterimit “ Adem Jashari”. Kurse, si projekte tjera janë: ndërtimi i rrugëve regjionale dhe lokale, bashkëfinancimet me Komunitat, mirëmbajtja e urave dhe rrugëve, pagesat në bazë të neni 39.2, pagesat me vendime të gjykatave, etj.

Për projektin ndërtimi i autoudhës Prishtinë - Hani i Elezit, në vitin 2018 janë kryer pagesa në vlerë 142,631,883€. Ne kemi aplikuar teste për qëllime substanciale për t’u siguruar se shpenzimet e paraqitura në pasqyra financiare prezantojnë gjendjen e vërtetë dhe të saktë. Aspekti i pajtueshmërisë nuk është trajtuar, për shkak se rasti i Autoudhës është në procedura hetimore nga organet kompetente.

Në ekzaminimet tjera, ne kemi aplikuar testime substanciale dhe të pajtueshmërisë, dhe kemi identifikuar parregullsitë si në vijim:

---

**Çështja A5 – Mos pjesëmarrja e zyrtarëve të MI-së në komisionet për hapje dhe vlerësim të ofertave në projektet për bashkëfinancim me komunat**

**Gjetja** Sipas memorandumeve të bashkëfinancimit me komuna, neni 4 pika 4, në hapje dhe vlerësim të tenderit duhet të jetë një anëtar nga MI, që të siguroj se ofertuesi fitues ka dorëzuar tërë dokumentacionin e kërkuar dhe se procesi i përzgjedhjes është bërë sipas legjislacionit në fuqi.

Nga mostrat e testuara, kemi identifikuar se në pesë raste zyrtarët e MI-së nuk kanë qenë pjesë përbërëse e komisionit për hapjen dhe vlerësimin e ofertave në proceset e prokurimit të zhvilluara nga komunat.

Kjo ka ndodhur me rastin e vlerësimit të tenderëve për projektet: (a) "Asfaltimi i rrugës në fshatin Poterq i Epërm" vlera e kontratës 258,804€; (b) "Asfaltimi i rrugës Mulliq – Potok" vlera e kontratës 37,357€; (c) "Asfaltimi i rrugës Brodosanë – Rezinë" vlera e kontratës 255,000€; (d) "Asfaltimi i rrugës Lushi – Dullovi" vlera e kontratës 214,354€ dhe (e) Projekti "Ndërtimi i rrugës Kryshec – Morinë", vlera e kontratës 728,322€.

Kjo ka ndodhur për shkak se komunat nuk i kanë njoftuar me kohë zyrtarët e MI-së për zhvillimin e procedurave të prokurimit, por edhe zyrtarët e MI-së janë treguar neglizhent që të marrin pjesë në proceset e prokurimit.

**Rreziku** Mos pjesëmarrja e zyrtarëve të ministrisë në komisionet për hapje dhe vlerësimin e ofertave të zhvilluara nga komunat, mund të rezultoj në përzgjedhjen e operatorëve të pa përgjegjshëm dhe mos informimin e ministrisë për dinamikën e projekteve.

**Rekomandimi A5** Ministri duhet sigurohet së zyrtarët e saj duhet të jenë pjesë e komisioneve në procesin hapjes dhe vlerësimit të ofertave, për t'u siguruar se proceset e prokurimit zhvillohen në kuadër të një transparence të plotë dhe në pajtim me rregulloret, si dhe të informohet me dinamikën e projekteve.

---

**Çështja A6 – Ngecjet në realizimin e projekteve në bashkëfinancim me komuna**

**Gjetja** Neni 5 pika 2 e Memorandumeve të bashkëpunimeve me Komunat obligon Komunën që t'i krijoj kushtet e nevojshme për realizimin e projekteve, dhe të ndërmerr masat që kontraktuesi pa pengesë të filloj me implementimin e projektit me kohë.

Ne kemi identifikuar se zbatimi i projekteve me bashkëfinancim me Komuna ka hasur në pengesa në realizimin e punimeve. Komunat janë zotuar dhe kanë nënshkruar memorandumet e bashkëpunimeve me MI për financimin e projekteve të caktuara, pa krijuar parakushtet e duhura për fillimin e punimeve.

Nga mostrat e testuara, ne kemi identifikuar se në katër (4) raste, zhvillimi i projekteve ishte paraparë brenda dy apo tri viteve. Ne kemi bërë analizën e progresit financiar të kontratave dhe konkluzioni është se projektet po realizohen me një dinamikë të ngadalshme.

Projektet me progres më të ultë të realizimit janë:

- “Unaza e jashtme në Ferizaj”, kontrata trevjeçarë me vlerë 2,865,167€ është nënshkruar më 15.11.2016, ndërsa realizimi i pagesave deri në fund të vitit 2018 ishte 624,333€ ose 21%;
- “Zgjerimi i rrugës Komogllavë –Tërstenik”, kontrata e nënshkruar me datën 10.11.2016 me vlerë 1,089,590€ për një periudhë trevjeçare, realizimi pagesave deri në fund të vitit 2018 është 275,088€ ose 25%;
- “Zgjerimi i rrugës Sadovinë e Jerlive – Dardani”, kontratë dyvjeçarë në vlerë 292,325€ e nënshkruar më 26.12.2017, ndërsa realizimi i pagesave deri në vitin 2018 është 166,917€ ose 57% dhe
- “Asfaltimi i rrugës te Xhamia”, kontratë dyvjeçarë e nënshkruar me datën 18.10.2017 në vlerë 487,688€ realizimi i pagesave deri në fund të vitit 2018 është 327,923€ ose 67%.

Kjo dinamikë e ultë e realizimit të projekteve ka ndodhur për shkak të problemeve pronësore të pazgjidhura, reagimet e qytetarëve dhe mos pajtimet me trasenë e rrugëve.

#### **Rreziku**

Ndarja e fondeve për bashkëfinancim të projekteve, para se komunat t’i kenë zgjidhur pengesat e përmendura, mund të shkaktoj ngecje në realizimin e projekteve, mos përfundimin e tyre brenda afateve të kontraktuara dhe mundësinë për shpenzime shtesë të projekteve. Kjo mund të ndikoj edhe në mosefikasitetin e shpenzimeve të buxhetit nga ana e ministrisë.

**Rekomandimi A6** Ministri duhet të siguroj që para se të arrihen marrëveshjet me Komunat për bashkëfinancimin e projekteve të caktuara, të sigurohet se komunat kanë rregulluar çështjet pronësore, kopjen e planit dhe pëlqimet për kyçe nga kompanitë komunale (rryma, uji dhe kanalizim). Në të kundërtën, të mos bëhet financimi i tyre.

---

**Çështja A7 - Nënshkrimi i kontratave me operatorë që nuk i kanë plotësuar kërkesat e përshtatshmërisë së dosjes së tenderit**

**Gjetja** Sipas Ligjit Nr. 04/L 042 të Prokurimit Publik (LPP) nenit 65 pika 4.1, operatori ekonomik nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse gjatë dy (2) viteve të kaluara është shpallur nga një gjykatë kompetente si i falimentuar ose insolvent, dhe pika 4.8, nëse aktualisht është me vonesë në pagimin e tatimit në Kosovë.

Me rastin vlerësimit të aktiviteteve të prokurimit, ne kemi identifikuar së në dy raste para nënshkrimit të kontratave nuk janë ofruar konfirmimet e kërkuara nga gjykata dhe Administrata Tatimore e Kosovës (ATK). Fjala është për:

- Nënshkrimi i kontratës “Ndërtimi i rrugës nacionale Deçan- Mali i Zi” me vlerë 4,191,313€; dhe
- Nënshkrimi i kontratës “Nedakovc - Smrekovnicë Lot II” me vlerë 2,067,455€.

Nënshkrimi i kontratave me operatorët ekonomik në mungesë të dëshmive të kërkuara, është rezultat i punës sëzyrtarëve të prokurimit për të administruar procesin sipas rregulloreve.

**Rreziku** Anashkalimi i kriterëve të dosjes së tenderit, rritë rrezikun e nënshkrimit të kontratave me operatorë të pa përgjegjshëm. Kjo dëmton transparencën e procesit dhe mundësinë e diskriminimit të operatorëve tjerë konkurrues.

**Rekomandimi A7** Ministri duhet t’i rishikoj dy rastet e mësipërme dhe të analizoj pse kanë ndodhur parregullsitë e përmendura, si dhe të siguroj se Departamenti i prokurimit do të zbatoj me përpikëri të gjitha kërkesat e rregulloreve të prokurimit në të ardhmen.

---

**Çështja A8 - Kohëzgjatja e kontratës jo në pajtueshmëri me njoftimin për dhënien të kontratës**

**Gjetja** Në njoftimin për kontratë pika 2.3, kohëzgjatja e kontratës apo afati kohor për përfundimin e punimeve ishte prej 20.05.2016 deri me 20.05.2017 për një periudhë një vjeçare.

Kontrata për “Hartimin e projekteve të rrugëve dhe strukturave Lot II” e nënshkruar me datën 08.06.2016, me çmimin për njësi 0.78€ me vlerë të përgjithshme vjetore prej 70,000€ ishte nënshkruar për periudhën kohore tre (3) vjeçare apo 36 muaj.

**Rreziku** Ndryshimi i afatit të kontratave me procedura të brendshme të zbatuara nga ministria, kundrejt njoftimit publik për dhënien e kontratës, rritë rrezikun e mashtrimit, transparencës së prokurimeve dhe manipulimit me kontrata.

**Rekomandimi A8** Ministri duhet ta shqyrtoj rastin e mësipërm dhe të fuqizoj kontrollet dhe masat e përgjegjësisë në zyrën e prokurimit, që nënshkrimi i kontratave të behët në pajtueshmëri të plotë me afatet kohore të publikuara në njoftimin për kontratë, dhe praktikatat e tilla të mos përsëriten në të ardhmen.

### Çështja C1 - Kontrata të nënshkruara pa sigurime të ekzekutimit

**Gjetja** Udhëzimi Operativ i Prokurimit Publik (UOPP), neni 27, thekson se siguria e ekzekutimit është paraparë të mbështetë përmbushjen e kontratës, do të kërkohet që të jetë si parakusht për nënshkrim dhe hyrje në fuqi të kontratës dhe duhet të jetë së paku 10% e vlerës së kontratës.

Kontrata “mirëmbajtja dhe riparimi i urave për vitet 2017-2019”, vlera e kontratës 3,615,499€, në kushtet e veçanta të kontratës - siguria e ekzekutimit ishte kërkuar 30,000€ apo 0.8% e vlerës së kontratës.

Në katër aktivitete tjera të prokurimit, shumica e sigurisë së ekzekutimit është kërkuar 10% nga vlera e përgjithshme e kontratës, dhe duhej të kishte afat mbulueshmërie deri në 30 ditë pas përfundimit të punimeve të përcaktuara në planin dinamik. Për katër rastet e mëposhtme, ne nuk gjetur dëshmi për ekzistencën e polisave të sigurimit:

- Rehabilitimi i rrugës M9 Prishtinë – Pejë me vlerën e kontratës 4,783,022€;
- Mirëmbajtja Investive e rrugëve – vlera e kontratës 168,146€;
- Asfaltimi i rrugës Potërq i Epërm – vlera e kontratës 258,504€; dhe
- Shtresimi dhe asfaltimi i rrugës M9 Dheu i kuq – vlera e kontratës 585,877€.

Mangësitë kanë ndodhur për shkak të lëvizjeve të shpeshta të personelit në zyrën e prokurimit dhe neglizhencës për sigurimin e këtyre dokumenteve, para nënshkrimit të kontratave.

**Rreziku** Nënshkrimi i kontratave pa siguri të ekzekutimit apo me vlerë më të ulët sesa vlera e përcaktuar me rregulloret e prokurimit, rritë rrezikun që në rast të shkëputjes së njëanshme të kontratave apo mos realizimit të projekteve konform kushteve të përcaktuara me kontratë, kompenzimet nga operatorët ekonomik të mos mbulohen.

---

**Rekomandimi C1** Ministri duhet të siguroj se janë ndërmarrë veprimet e duhura që zyra e prokurimit të ofroj siguri se zhvillimi i proceseve të prokurimit që nga iniciimi i aktiviteteve, deri në nënshkrimin e kontratave, zhvillohet brenda kornizës ligjore, apo në mënyrë specifike të kërkoj nga menaxheri i prokurimi të mos nënshkruhen kontratat pa dëshmitë për sigurinë e ekzekutimit të projekteve.

---

#### **Çështja A9 - Mangësi në hartimin e projekteve nga kompania e kontraktuar nga MI**

**Gjetja** Sipas dosjes së tenderit – paramasës dhe parallogarisë, nga projektuesit kërkohet që me rastin e hartimit të projektit kryesor për rrugë, duhet përfshirë matjet gjeodezike, punimi i shqyrtimeve gjeomekanike të nevojshme për punimin e projektit kryesor, shpimet në thellësi 8-15 metra, analizat laboratorike dhe punimi i elaboratit gjeoteknik.

Në dy raste hartimi i projekteve të rrugëve nuk ishte punuar sipas paramasës dhe specifikacionit teknik të detyrueshëm. Në mungesë të kësaj, qysh në fillim të ndërtimit të rrugëve janë paraqitur probleme dhe projektet kanë rezultuar me punë shtesë dhe kishte lindur nevoja për revidimin e projekteve ekzekutuese, për të mundësuar vazhdimin e punimeve për ndërtimin e rrugëve.

Kërkesat për ndryshimin e projekteve janë paraqitur nga Menaxherët e projekteve pranë zyrës së prokurimit. Kërkesat për ri hartim të projekteve janë aprovuar nga komisionet përkatëse për aprovimin e punëve shtesë.

Projekti “Ndërtimi i rrugës nacionale Deçan – Mali Zi “ kontrata bazë në vlerë 4,191,313€, menaxheri i projektit ka kërkuar ri hartimin e projektit me arsyetimin se projekti i kishte këto mangësi: matjet gjeodezike ishin bërë shumë të cekëta, incizimi i pamjaftueshëm i gjendjes ekzistuese dhe profilet tërthore pasqyronin terrenin e gabuar. Me rekomandim të komisionit, është ri hartuar projekti dhe me këtë rast është nënshkruar aneks kontratë për punën shtesë në vlerën prej 414,725€.

Projekti “Riasfaltimi i rrugës rajonale 220 segmenti Bukosh - Prilluzhë” vlera e kontratës bazë 1,990,332€. Arsyet për ri hartimin e projektit ishin: ndryshimet e sasive nga projektuesi dhe gjendja reale në terren, pengesat pronësore, kërkesat për ndryshimin trasesë së rrugës si dhe pozicioni i ndryshimit të urës së projektuar me atë të urës ekzistuese në terren. Puna shtesë e vlerësuar e ndërtimit kap vlerën prej 194,440€, kurse aneks kontrata pritët të nënshkruhet pas përfundimit të procedurave të prokurimit.

---

**Rreziku** Hartimi i projekteve jo në pajtueshmëri me specifikacionet teknike, rezulton me mos ndërtimin rrugëve në afatet e parapara me kontratë, pamundëson planifikimin e vlerës reale të investimeve, dhe mund të shkaktoj shpenzime shtesë të projekteve.

**Rekomandimi A9** Ministri duhet të siguroj se para se të hartohen projektet ekzekutive, të jenë kryer të gjitha ekzaminimet në terren, përfshirë matjet gjeodezike, incizimi i gjendjes reale në terren, zgjidhja e çështjeve pronësore dhe përcaktimi i saktë i trasesë së rrugëve. Më pas, të përcaktohet paramasa dhe parallogaria e projektit, në mënyrë që të reduktohet mundësia e tejkalimit të punimeve të parapara me kontratë.

---

### Çështja A10 - Ri hartim i projektit pa procedura të prokurimit

Sipas UOPP, neni 61 menaxhimi i kontratës, ndër tjera, menaxheri i kontratës është përgjegjës t'i siguroj detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës departamentit të prokurimit dhe ta merr miratimin e tij.

Projekti kryesor "Ndërtimi i rrugës nacionale Deçan – Mali i Zi" me një kosto ndërtimi prej 4,191,313€ nuk ishte projektuar saktë, dhe ri hartimi i projektit ishte bërë nga një kompania e cila nuk ishte kontraktuar nga MI.

Kërkesa për ri hartim të projektit nga menaxheri i projektit është pranuar nga menaxhmenti i MI-së. Për këtë rast ishte formuar komision për vlerësimin e kërkesës për aprovimin e punëve shtesë, dhe komisioni kishte marrë vendim dhe kishte konfirmuar nevojën për ri hartimin e projektit.

Ky ndryshim ka ndodhur pasi që matjet gjeodezike dhe parametrat e projektuar nga kompania ishin jo të sakta, dhe punëkryesi e ka pasur të pamundshme vazhdimin e kryerjes së punimeve. Projekti i hartuar dhe gjendja në terren kishin mospërputhje, dhe menaxheri i projektit me arsyetim se projekti është i rëndësisë së veçantë, ka angazhuar një kompani tjetër për ri hartimin e projektit, kompani me të cilën MI nuk kishte kontratë të nënshkruar.

**Rreziku** Ekzaminimet dhe analizat e dobëta para se projekti të hartohet, shpien në nevojën për korrigjimet e mëvonshme të projekteve. Angazhimi i operatorëve ekonomik për shërbime projektuese pa procedura të prokurimit, rritë mundësinë e hartimit të projekteve në mënyrë të pa autorizuar dhe shmangien e përgjegjësisë në rast të dështimeve.

**Rekomandimi A10** Ministri duhet të siguroj se në rastet kur imponohet nevoja e korrigjimeve teknike në projekte, procesi i ri hartimit të projekteve bëhet vetëm pasi të jenë zhvilluar procedurat e prokurimit, apo nga kompanitë që janë të kontraktuara nga Ministria.

---

**Çështja A11 - Pranimi teknik i punëve dhe projekteve nga komisionet me përbërje jo kompetente**

**Gjetja** Sipas Udhëzimit Administrativ Nr.2008/3 nenit 2 pika 3 e thekson se anëtarët e komisionit të ekspertëve për mbikëqyrje të punëve, pranim teknik dhe kolaudimin e punëve të kryera duhet të jenë persona me kualifikim dhe njohuri të specializuara në sektorin e infrastrukturës rrugore nga lëmi i ndërtimtarisë, sigurisë në komunikacionin rrugorë, e të ngjashëm.

Nga gjithsej pesë mostra të testuara, ne kemi identifikuar se në dy (2) raste përbërja e komisioneve për pranimin e punëve nuk ishte nga anëtarët me kompetencën dhe njohuritë nga fusha e kërkuar. Komisionet përbëheshin nga një inxhinierë dhe dy anëtarë tjerë të fushave jo profesionale.

Për projektet “ Ndërtimi i rrugës Vojnik-Osojan Lot 2” si dhe për projektin ‘Ri-asfaltimi i rrugës rajonale R220, segmenti Bukosh - Prilluzhë’, pranimi teknik dhe vlerësimi i gjendjes së ndërtimit, ishte bërë nga komisionet në përbërje: një inxhinier, një ekonomist dhe një jurist.

Kjo kishte ndodhur për shkak të numrit të madh të projekteve dhe numrit të pamjaftueshëm të inxhinierëve.

**Rreziku** Pranimi teknik dhe vlerësimi i gjendjes së ndërtimit nga zyrtarë jo kompetent, rritë rrezikun e pranimin të projekteve jo në pajtueshmëri me standardet dhe cilësinë e kërkuar, dhe mund të rezultoj me shpenzime shtesë të mëvonshme për Ministrinë.

**Rekomandimi A11** Ministri duhet të siguroj se pjesë e komisioneve për pranimin e projekteve dhe punëve, do të jenë zyrtarët me kualifikime përkatëse, me njohuri të specializuar në infrastrukturën rrugore, që do të ofronin siguri se projektet janë realizuar në pajtueshmëri të plotë me standardet e ndërtimit.

---

**Çështja A12 - Mangësi në zhvillimin e procedurave të prokurimit për projektin “Mirëmbajtja e Urave 2017-2019”**

**Gjetja** Sipas Udhëzuesit Operative të Prokurimit Publike (UOPP), neni 56.10, sasia e parashikuar e specifikuar në dosje të tenderit është vetëm sasi indikative. Autoriteti Kontraktues do të specifikoj në dosje të tenderit vlerën ose sasinë e kontratës si një prag apo tavan dhe mund të lejoj devijimet prej tij deri në plus – minus 30%.



Njësia kërkuese kishte bërë kërkesë në zyrën e prokurimit për inicimin e procedurave të prokurimit përmes një kontrate kornizë për mirëmbajtjen e urave për vitet 2017-18 dhe 2018-19.

Zyra e prokurimit me datën 01.08.2017 kishte bërë njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit përmes procedurës së hapur. Në dosje të tenderit janë vendosur sasi të indikative dhe kriteri i dhënies së kontratës ishte çmimi më i ultë për njësi. Procesi i prokurimit ka rezultuar me lidhjen e kontratës publike për periudhë dy vjeçare me çmimin për njësi prej 4,348€. Vlera e kontratës për dy vite arrin shumën 3,615,499€. Në dosje nuk kemi hasur ndonjë arsyetim të vlefshëm pse zyra e prokurimit nuk ka përdorur kontratën kornizë, por kontratë publike.

**Rreziku** Mos përdorimi i kontratës kornizë në rastet kur dihen sasi të përafërta për furnizim apo ndërtim, rritë rrezikun e manipulimeve me artikujt të cilët janë ofruar me çmim më të lartë.

**Rekomandimi A12** Ministri duhet siguroj se me rastin zhvillimit të procedurave të prokurimit kur kemi të bëjmë me furnizime apo me punë ku dihen sasi të përafërta, të merr në konsiderim sugjerimet paraprake të njësive kërkuese të prokurimit për llojin e kontratave dhe procedurat për të parandaluar mundësinë e manipulimeve.

## 3.2 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Menaxhimi i pasurisë është pjesë e rëndësishme e menaxhimit financiar dhe kontrollit në sektorin publik. Kjo kërkon procedura të kontrollit dhe menaxhimit të cilat vërtetojnë ekzistencën e pasurive dhe sigurojnë të dhëna të sakta dhe të azhurnuara për pasuritë e organizatës. Vlera e pasurive mbi 1,000€ e prezantuar në PFV ishte 1,440,609,472€, ndërsa nën 1,000€ ishte 457,816€.

Përveç çështjeve të potencuara tek kapitulli opiniononi i auditimit, ne kemi identifikuar edhe çështjet si më poshtë.

---

### Çështja C2 - Mangësi në inventarizimin dhe menaxhimin e pasurive

**Gjetja** Bazuar në Rregulloren MF- Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, neni 19, pika 4.6 dhe 4.7 Komisioni për inventarizimin e pasurisë, pas përfundimit të punës kërkohet të përgatit raport për kryerjen e inventarizimit, dhe raport të përgjithshëm në bazë të raporteve individuale të komisionit, para përgatitjes së PFV.

Komisioni për inventarizim ka kryer inventarizimin e pasurive jo financiare, ku janë plotësuar formularët e regjistrimit nga departamentet përkatëse, por nuk është përgatitur raporti i përgjithshëm për kryerjen e inventarizimit. Ekziston mos konsistenca në mes formularëve të inventarizimit dhe regjistrit të pasurive, pasi çdo pagesë që kryhet nga kategoria e Investimeve kapitale regjistrohet si pasuri, përkundër që nuk plotësojnë kriterin e pasurisë.

Komisioni për vlerësim të pasurive ka identifikuar 195 pasuri (tavolina, karrige dhe sirtarë) të cilat nuk kanë vlerë të bartur dhe që duhej të asgjësoheshin. Pas asgjësimit të këtyre pasurive, vetëm 31 prej tyre janë larguar nga regjistri i pasurive, kurse pjesa tjetër ka mbetur ende në regjistra të pasurive jo kapitale nën 1000€.

Kjo ka ndodhur shkak i menaxhimit të pasurive nga nëpunës jo kompetent dhe pa përvojë adekuate në fushën e menaxhimit të pasurive.

**Rreziku** Mungesa e raportit përfundimtar për inventarizimin e pasurisë, pamundëson konfirmimin e ekzistencës së pasurive. Ndërsa, regjistrimi i çdo shpenzimi kapital si rritje e pasurive, ndikon në mbivlerësimin financiar të gjendjes së pasurive dhe prezantimin e tyre të pasaktë në pasqyrat financiare të fundvitit.

**Rekomandimi C2** Ministri duhet të siguroj që anëtarët e komisionit për inventarizim dhe vlerësim të pasurisë, dhe zyrtarë për menaxhimin e pasurive të emërohen nëpunës kompetent dhe profesional që do të mundësonin inventarizimin e plotë, raportimin dhe menaxhimin e pasurive në pajtim me kërkesat ligjore.

### 3.3 Të arkëtueshmet

Sipas PVF-ve 2018, shuma e pa arkëtuar e të hyrave në fund të vitit ishte 195,069€. Këto llogari i takojnë departamenteve të ndryshme, ndërsa në këtë kategori ne kemi ekzaminuar pesë mostra për nevoja të testeve substanciale dhe të pajtueshmërisë. Nga testimet e kryera, nuk kemi identifikuar ndonjë parregullsi.

#### Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë

### 3.4 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2018 ishte 38,495,831€. Këto obligime janë bartur për t'u paguar në vitin 2019. Obligime të pa paguara nga kategoria e investimeve kapitale ishin 38,108,381€, ku vetëm për projektin ndërtimi i Autoudhës R6 Prishtinë-Han i Elezit ishin 32,906,209€. Nga kjo shumë, për punët dhe situacionet e rregullta të pa paguara ishin 24,356,209€, dhe vlera prej 8,550,000€ i takon pjesës 53,100,000€ të aprovuara si shpenzime

shtesë për Autoudhën. Ndërsa, pjesa e obligimeve prej 5,202,172€ i takon projekteve tjera infrastrukturore.

Arsyet e mos pagesës së faturave ishte mungesa e buxhetit.

Obligimet e papaguara në kategorinë mallra dhe shërbime ishin 384,680€ dhe obligimet për komunal 2,768€. Megjithatë, kjo pasqyron vetëm një pjesë të vështirësive buxhetore me të cilat përballet Ministria. Krahasuar me vitin paraprak, vërehet një rritje e obligimeve për 10,317,337€ apo 45%. Ne kemi aplikuar testime substanciale dhe të pajtueshmërisë, dhe nga testimet e bëra, kemi identifikuar parregullsitë si në vijim:

### Çështja C3 – Mangësi në menaxhimin e obligimeve

**Rreziku** Sipas Rregullës Financiare 01-2013, neni 37 – Shpenzimi i parave publike, OB obligohet që çdo faturë të pranuar, të vlefshme për pagesë, ta paguaj brenda 30 ditëve kalendarike nga data e pranimit të faturës.

Ministria ka kontrolle jo efektive në menaxhimin e obligimeve. Si rezultat i kësaj, gjatë vitit 2018, me vendime të Thesarit dhe vendime gjyqësore janë paguar mbi 4.5 milionë obligime të pa paguara gjatë vitit 2018 dhe nga vitet paraprake. Edhe këtë vit, nuk vërehen përmirësime në këtë fushë.

Vetëm në kategorinë e investimeve kapitale, shuma e obligimeve të papaguara ishte 38,108,381€, por ka edhe detyrime tjera të pa paguara për mallra dhe shërbime.

**Rreziku** Vazhdimi i praktikave jo efektive në menaxhimin e obligimeve, dhe rritja e vazhdueshme e tyre, mund të ekspozoj ministrinë para vështirësive financiare dhe të sjellë në pikëpyetje edhe realizimin e projekteve infrastrukturore. Veç kësaj, ministria mund të jetë edhe subjekt i proceseve gjyqësore të cilat mund të rrisin edhe më shumë koston e këtyre obligimeve.

**Rekomandimi C3** Ministri së pari duhet të siguroj se ekzistojnë fondet e sigurta për pagesën e obligimeve të mbetura nga vitet e mëhershme, dhe se të gjitha faturat e arritura gjatë vitit, do të paguhen brenda afateve të përcaktuara ligjore.

## 4 Qeverisja e mirë

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmer veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK nga ana e organizatave

buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen Ministrisë së Financave. Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentët tjerë janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

## Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston një numër i dobësive të qeverisjes brenda MI, veçanërisht në lidhje me organizimin e brendshëm dhe koordinim jo i mirë ndërmjet strukturave qeverisëse. Ndryshimet e shpeshta të stafit në departamentin e prokurimit kanë ndikuar në parregullsi të shumta të aktiviteteve të prokurimit.

Po ashtu, ekzistojnë dobësi në lidhje me performancën e organizatës për të ofruar vendimmarrje më të mirë, shërbime më të mira dhe vlerë më të mirë për paratë e dhëna. Është shumë e rëndësishme që procesi i prokurimit publik të kryhet me transparencë dhe drejtësi, dhe që siguron vlerën më të mirë për paratë publike.

Fusha e prokurimit aktualisht përcillet me rreziqe të larta për shkak të kontratave të shumta dhe volumit të madh të buxhetit. Projektet infrastrukturore, shumica janë projekte shumëvjeqare, por në raste të caktuara projektet fillohen pa zotim shumëvjeqar të fondeve, por vetëm me zotime të pjesshme. Inicimi i procedurave bëhet para se të sigurohen projektet ekzekutive, dhe si rezultat i kësaj, revidimi i projekteve bëhet në fazat pasi të kenë filluar punimet.

Si shkak i dështimit të kontrolleve, ishin bërë pagesa të parregullta për shkak të neglizhencës në zhvillimin e procedurave të prokurimit. Kjo, ka ndodhur me pagesat për dislokimin e varrezave nga Traseja e Autoudhës Prishtinë – Hani i Elezit, ku pa kontratë ishin paguar mbi 353 mijë euro vetëm në vitin 2018. Pagesat ishin bërë duke iu referuar çmimeve të një kontrate të vitit 2016, por e cila ishte kontratë e skaduar.

Menaxhim jo i mirë është identifikuar edhe me kontratat për shërbime të veçanta, ku 135 persona ishin punësuar në bazë të këtyre marrëveshjeve. Madje, 29 të tjerë nuk kishin fare kontrata, dhe të njëjtit janë paguar për vitin 2018, në tremujorin e parë të vitit 2019. Ndonëse edhe ligji e lejon mënyrën e tillë të angazhimit të stafit, vërejtjet tona janë në mos zbatimin e procedurave të kërkuara për rastet e tilla.

Ministria nuk ka zbatuar pjesën më të madhe të rekomandimeve, megjithatë ka përgatitur regjistrin e rreziqeve dhe pyetësorin e vetëvlerësimit, duke identifikuar rreziqet që mund të kenë ndikim tek organizata në lidhje me arritjen e objektivave të saj. Auditimi i brendshëm kishte ngritur shumë çështje mbi cilësinë dhe efektivitetin e kontrolleve të brendshme dhe kishte dhënë rekomandime përkatëse për përmirësimin e tyre.

---

## 4.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me tre anëtarë të stafit - Drejtori i NjAB dhe dy auditorë. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës që reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të entitetit të audituar dhe që ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i raporteve të auditimit të brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja e ofruar nga një Komitet efektiv i Auditimit.

Njësia e auditimit të brendshëm në MI për 2018 ka planifikuar 18 auditime. Deri në dhjetor të vitit 2018, kjo njësi ka realizuar 13 auditime të planifikuara. MI kishte përgatitur plan për zbatimin e rekomandimeve të NJAB-it dhe është në proces të zbatimit të tyre. Gjithashtu, NJAB ka përgatitur raporte gjashtëmujore për aktivitetet e saj në NJQHAB në MF.

### Rekomandime

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë

## 4.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranimit i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalesje e rezultateve në mënyrë transparente.

Konkluzionet tona janë se ka mangësi në procesin e raportimit. Komunikimi në mes njësive organizative të ministrisë kërkon përmirësime të dukshme. Nga gjetjet e theksuara në raport, shuhet se llogaridhënia është e dobët, dhe si pasojë e kësaj, kanë ndodhur shumë parregullsi.

Menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën. Duke qenë se ministria ka një veprimtari të gjërë dhe buxhet të madh, rreziqet janë mjaft të larta. Menaxhmenti duhet në mënyrë sistematike t'i shqyrtoj aktivitetet për të reduktuar rreziqet në nivele të pranueshme.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, ne kemi vërejtur se masat e aplikuar janë të dobëta dhe jo efektive, dhe nuk mundësojnë një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuar.

## 5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2017 të MI-së ka rezultuar në 19 rekomandime kryesore. MI kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2018, nëntë (9) rekomandime janë zbatuar; tre (3) ishin në proces, katër (4) të mbyllur të pazbatuar, dhe tre (3) nuk janë adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve)

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2018

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2017	Veprimet e ndërmarrë	Statusi
1	PFV - Kualifikimi i opinionit	Ministri duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për kualifikimin e opinionit. Përgatitja e PFV-ve t'i nënshtrohet kontrolleve dhe rishikimit të duhur më qëllim që të mos përsëriten gabimet në prezantimin e huamarrjeve dhe të hyrave nga AKP;	Sa i përket gabimeve në PFV, janë marr masa dhe në PFV të 2018 nuk kemi identifikuar gabime të tilla.	Rekomandim i zbatuar.
2	Theksimi i çështjes	Ministri duhet të analizoj shkaqet e theksimit të çështjes dhe të siguroj/ndërmarrë veprime specifike për t'i eliminuar gabimet në klasifikimin e shpenzimeve dhe të siguroj prezantim real të pasurive të Ministrisë.	Keq klasifikimi i shpenzimeve për MVD ekziston, pasi kontratat e lidhura nuk i ndajnë pozicione për mirëmbajtje investive nga shërbimet. Në theksim të çështjes janë trajtuar çështje të tjera, si pagesat e parregullta, pagesat e dyfishta.	Rekomandim i pazbatuar.

3	Pagat dhe Shtesat	Ministri duhet të sigurojë zgjidhje të qëndrueshme për pozitat ushtrues detyre dhe pajtueshmëri të plotë me kornizën ligjore.	MI nuk ka ndërmarr masa, derisa pozitat me UD kanë vazhduar për periudhë më gjatë se tre muaj (15 pozita sipas të dhënave të personelit).	Rekomandim i mbyllur i pazbatuar.
4	Menaxhimi i Personelit	Ministri duhet të siguroj kontrolle adekuat në fushën e personelit, të ndërmerren hapat e duhur për zbatimin e legjislacionit në fuqi dhe të siguroj menaxhim efikas dhe efektiv të organizatës në drejtim të realizimit të objektivave të saj.	MI ka të angazhuar 32 nëpunës nga komunitet që nuk vijojnë fare në punë. Kjo është trajtuare te theksimi i çështjes së opinionit.	Rekomandim i pazbatuar.
5	Mallra dhe Shërbime	Ministri duhet të siguroj menaxhim të mirë dhe të forcoj kontrollet në realizimin e shpenzimeve, të siguroj klasifikimin e duhur të tyre për një pasqyrim të drejt dhe të saktë financiar.	Nuk kemi identifikuar keq klasifikim brenda kategorisë ..	Rekomandim i zbatuar.
6	Mallra dhe Shërbime	Ministri duhet t'i forcoj kontrollet në zyrën e prokurimit dhe njësisë kërkuese, në mënyrë që për furnizimet e njëjta të aplikohet procedurë adekuate/e hapur e prokurimit dhe kontraktimit.	Nuk kemi identifikuar raste të tilla.	Rekomandim i zbatuar.



7	Investimet Kapitale Dobësi në menaxhimin e projekteve në bashkëfinancim me Komunitet përkatese	Ministri duhet të siguroj menaxhim të mirë të projekteve në bashkëfinancim dhe nëpërmjet departamentit të Menaxhimit të Rrugëve të forcoj kontrollet në pranimin e shërbimeve nga organet e vendosura mbikëqyrëse.	Projekte e përfunduar	Rekomandim i mbyllur i pazbatuar.
8	Keq-klasifikimi i mjeteve nga kategoria e investimeve kapitale dhe mangësi në procesin e pranimit	Ministri në bashkëpunim me ZKF dhe Departamentin për menaxhimin e rrugëve duhet të identifikojnë masat që duhen të ndërmerren në mënyrë që pranimet e situacioneve të shpalosin saktë se cila vlerë në kuadër të pagesës reflekton mirëmbajtjen e cila investimet kapitale. Po ashtu, në bashkëpunim me MF mjetet të klasifikohen/buxhetohen saktë në kategori ekonomike të cilat kanë ndikim material në PFV-të e organizatës.	Keq klasifikimi ekziston, lidhet me theksimin e çështjes, rekomandimi 2.	Rekomandimi i pazbatuar.
9	Hyrja në obligime kontraktuale pa mbuluesh mëris të mjaftueshme financiare	Ministri duhet të forcoj kontrollet gjatë zhvillimit të projekteve duke siguruar që para inicimit të procedurave të prokurimit çdo projekt kapital të ketë fonde të mjaftueshme për realizimin e tij.	Nuk kemi identifikuar raste të njëjta të IK.	Rekomandim i zbatuar.
10	Parregullsi në njoftimin për dhënie të kontratës	Ministri duhet të siguroj kontrolle në fushën e prokurimit duke përcaktuar shkaqet e mos përmbushjes së kërkesave ligjore në prokurimin e zhvilluar, më qëllim eliminimin e tyre në të ardhmen.	Nuk kemi identifikuar raste të njëjta të IK.	Rekomandim i zbatuar.
11	Sigurive të ekzekutimit ju kishte skaduar afati i mbulues mërisë	Ministri duhet të siguroj/ndërmerre një rishikim për të identifikuar pse kërkesat e prokurimit nuk janë zbatuar dhe të siguroj kontrolle adekuate që dështimet e tilla nuk do të ndodhin në të ardhmen.	Nuk ekzistojnë raste të tilla, mirëpo kemi raste kure janë nënshkrua	Rekomandim në proces të zbatimit.

			re kontrata pa siguri të ekzekutimi.	
12	Planifikimi i duhur i aktiviteteve të prokurimit dhe mangësi në prezantimin e raportit për kontratat e realizuara	Ministri duhet të siguroj kontrolle adekuate dhe në bashkëpunim me zyrën e prokurimit duhet të eliminojnë parregullsitë duke mbledhur kërkesat e sakta prej çdo njësie kërkuese të organizatës në mënyrë që të gjitha procedurat e realizuara të prokurimit të jenë në përputhje me planin final. Çdo kontratë duhet të jetë e pasqyruar në raportin vjetor të kontratave të nënshkruara publike.	Nuk janë ndërmarre veprime për ta korigjuar e rexhistrin e kontratave vitit paraprake .	Rekomandimi mbyllur pa zbatuar.
13	Vonesa nga hapja e ofertave deri tek vlerësimi i tyre	Ministri duhet të siguroj mekanizma në forcimin e kontrolleve në fushën e prokurimit duke u aplikuar saktë afatet kohore e parapara në LPP.	Nuk ekzistojnë raste të tilla.	Rekomandimi zbatuar.
14	Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale	Ministri së bashku me zyrën e financave duhet të forcoj kontrollet në realizimin e shpenzimeve dhe të siguroj pajtueshmëri të plotë me hapat e përcaktuara me LMFPP-në dhe me rregullat e Thesari.	Nuk ekzistojnë raste të tilla.	Rekomandimi i zbatuar.
15	Pasuritë Kapitale dhe jo-kapitale	Ministri, duhet t'i rishikoj kontrollet ekzistuese në menaxhimin e pasurisë. Kontrollet në këtë fushë duhet të forcohen në mënyrë që pasuritë të evidentohen, vlerësohen dhe regjistrohen si duhet si dhe të ruhen nga humbja keqpërdorimi.	Kane marr masa është formuar komisioni për inventarizim, mirëpo komisioni nuk kishte përgatitur	Rekomandimi në proces të zbatimit.

			e raportin përgjithshëm të inventarizimit.	
16	Obligimet e papaguara	Ministri duhet të siguroj kontrole adekuate dhe menaxhim të mirë të obligimeve, të analizoj arsyet për rritjen e tyre, obligimet ndaj furnitorëve paguhen brenda afatit ligjor që të shmangen kostot shtesë, si dhe të sigurojë se raportimi i obligimeve të papaguara bëhet në përputhje me rregullat.	Kane marr masa që megjithatë ekzistojnë ende raste të tilla kemi rritje të obligimeve në raporte me vitin paraprak, mirëpo raportimi i obligimeve ishte në pajtueshmëri me rregullat ligjore.	Rekomandimi në proces të zbatimit.
17	Progresi në zbatimin e rekomandimeve	Ministri duhet të zbatojë një proces efektiv për monitorimin e implementimit të rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm (AP), i cili përcakton kohën e synuar dhe zyrtarët përgjegjës për këtë. Rekomandimet të cilat nuk implementohen sipas afateve, të rishikohen në një afat të shkurtër, si dhe të ndërmerren veprime pro-aktive ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit.	Kane marr masa megjithatë ekzistojnë ende raste të tilla.	Rekomandimi i mbyllur i pa zbatuar.
18	Sistemi i auditimit të brendshëm	Ministri, në bashkëpunim me Komitetin e Auditimit, duhet të rishikojnë në mënyrë kritike planet e auditimit të brendshëm, për të konfirmuar se ato bazohen në proceset e vitit aktual dhe i ofrojnë sigurinë e kërkuar menaxhmentit.	Janë marr masa nga NJAB.	Rekomandimi i zbatuar.
19	Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe	Ministri duhet të ndërmerr masat e duhura për identifikimin e vazhdueshëm të të gjitha rreziqeve domethënëse si mjete të cilat testojnë efektivitetin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit në përkrahjen e objektivave të organizatës.	MI ka përgatitur regjistrin e rreziqeve.	Rekomandimi i zbatuar.

	menaxhim i i rrezikut			
Nr	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2018		
1	Opinion i Auditimit	Ministri duhet të siguroj se është bërë një analizë për të përcaktuar shkaqet për për Theksim të Çështjes në Opinion. Veprime specifike duhet të ndërmerren për t'i adresuar shkaqet për të eliminuar keq klasifikimet dhe pagesat e parregullta, pagesat e dyfishta që duhet të jenë në përputhje me kërkesat e ligjeve në fuqi.		
2	PVF	Po ashtu duhet të siguroj se me rastin e përgatitjes së PFV të vendos proceset efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV-ve për vitin 2019 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Të siguroj se do të ndërmerren hapa për të siguruar të prezantim te sakte te obligimeve te papaguara ashtu siç kërkohet me rregullat e thesarit.		
3	Realizimi i Buxhetit	Ministri duhet të ndërmerre veprime për funksionalizimin me kohe të njesive zbatuese të projekteve ne menyre që projekte kaptale të realizohen konforme marrveshjeve të arritura.		
4	Paga dhe Mëditje	Ministri duhet të ndërmarrë veprime ne koordinim me MF dhe MAP të rishikojnë mundësinë që për pozitat e rregullta të zgjidhje në kuadër të ligjit për shërbimin civil.		
5	Mallra dhe Shërbime	Ministri duhet të sigurojë se janë ndërmarre veprime për forcimin e kontrolleve që të arrihet një koordinim me mirë ndërmjet njësisë kërkuese, menaxherit të kontratave, dhe zyrës së prokurimit, të mos lejohet tejkalimi i sasive dhe vlerës se kontratës, në të kundërtën menaxheri i kontratës të rekomandoje zyrën e prokurimit për shkëputjen e kontratave.		
6	Investime Kapitale	Ministri duhet sigurohet së zyrtaret e saj duhet të jenë pjese e komisioneve në procesin hapjes dhe vlerësimit të ofertave, për të marr siguri së proceset e prokurimit zhvillohen me një transparence të plotë dhe pa diskriminim.		
7	Investime Kapitale	Ministri duhet të siguroj që para se të arrihen marrëveshjet me Komunat për financimin e projekteve të caktuar, duhet sigurohet së komunat kanë rregulluar certifikatën pronësisë, kopjen e planit dhe pëlqimet nga kompanitë komunale rryma, uji dhe kanalizim, ne të kundërtën të mos behet financimi i tyre.		
8	Investime Kapitale	Ministri duhet siguroi menaxhim adekuat të proceseve të prokurimit, menaxheri i prokurimit të mos nënshkruajnë kontrata me operatorët ekonomik pa i përmbushure kërkesat e dosjes së tenderit dhe të promovohet transparenca e plotë me rastin e nënshkrimit të kontratave.		
9	Investime Kapitale	Ministri duhet të rrisë kontrollet në zyrën e prokurimi që nënshkrimi i kontratave të behët ne pajtueshmëri me afatet kohor të parapara në njoftimin për kontrate dhe rastet e kësaj natyre të mos përsëriten në të ardhmen.		
10	Investime Kapitale	Ministri duhet të siguroi se janë ndërmarre veprimet për të forcuar kontrollet, zyra e prokurimit ofroj siguri se zhvillimi i proceseve të prokurimit që nga inicimi i aktiviteteve deri nënshkrimin e kontratave procesi zhvillohet brenda		

		kornizës ligjore, specifikisht të kërkoje nga menagjeri i prokurimi të mos nënshkruhen kontratat në mungesë të dëshmive për sigurinë e ekzekutimit të projekteve.
11	Investime Kapitale	Ministri duhet të siguroj kontrolle në hartimin e projekteve, të sigurohet që projekte janë të punuara konforme paramases dhe specifikacionit teknik, hartimi i projekteve të përgjigjet nevojave reale të terrenit dhe të bazohet në standardet teknike për projektimin e rrugëve.
12	Investime Kapitale	Ministri duhet të siguroj se procesi i ri hartimit të projekteve të behet vetëm nga kompanitë që janë të kontraktuara nga Ministria.
13	Investime Kapitale	Ministri duhet të siguroj që pjese e komisioneve për pranimin e projekteve dhe punëve të bëhet me përmes zyrtareve me kualifikimi përkatëse, me njohuri të specializuar në infrastrukturën rrugore, që do të ofroni siguri se projektet janë realizuar në pajtueshmëri të plotë me standardet e ndërtimit.
14	Investime Kapitale	Ministri duhet siguroje së me rastin zhvillimit të procedurave të prokurimit që kemi të bëjmë me furnizime apo me punë ku dihen sasitë e përafërta, blerjet apo furnizimet të behen përmes kontratave publike kornize, e cila i parandalon ndryshimet e mëdha në nivele të pozicioneve ndërmjet sasive të përafërta dhe atyre të realizuara.
15	Menaxhimi i Pasurive	Ministri duhet të siguroj që na zyrtari për menaxhim e pasurisë, anëtarët e komisionet për inventarizim dhe vlerësimi të pasurisë të emërohen nëpunës kompetente dhe profesional që do të mundësoni menaxhimin dhe raportimin e vlerës financiarë të pasurive në pajtueshmëri me kërkesat ligjore.
16	Obligimet e Papaguar	Ministri duhet sigurohet se janë forcuar mekanizmat e kontrollit rreth menaxhimit të obligimeve, duke mos hyre në marrëdhënie kontraktuale në mungesë të fondeve.

---

## Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

---

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet të japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.



## Shtojca II: Letër Konfirmimi.

REPUBLIKA EKSDHSH/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE TRANSPORTIT MINISTERIYO INFRASTRUKTURE I TRANSPORTA MINISTRY OF INFRASTRUCTURE AND TRANSPORTATION			
Njësia org. Org. Unit	04	Ka. i Post. Post. No.	6767
Nr. Fajet No. Pages	01	Data Date	25.06.19
PRISHTINE/A			

### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2018 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Infrastrukturës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturën dhe rekomandimin dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimit, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tij.

Z. Betim Redica

Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Infrastrukturës

Data: xx.qershor.2019, Prishtinë,